



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:089728

Datë: 17.10.2023

Numri i dokumentit: 04793827

PPP.nr. 718/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtoreshen profesionale Fatmire Haziri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditoresh S. M , nga Prishtina, Rruga, “.....”, kundër debitoresh Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK”, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori me datë 18.03.2021, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.61/2021, i datës 02.03.2021, i lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET prapësimi i debitoresh Komuna e Prishtinës, ashtu që ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.91/21, i datës 02.03.2021, i lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, dhe ABROGOHEN të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbarimore.
- II. REFUZOHET I PABAZUAR propozimi për përmbarim i kreditoresh S, M , i datës 02.03.2021, kundër debitorës Komuna e Prishtinës.

A r s y e t i m

Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të parashtruar nga kreditorja S.M , ka lejuar përmbarimin në bazë të Urdhrit Përmbarimor P.nr.61/21, i datës 02.03.2021, në bazë të dokumentit përmbarimor – Vendimit të Inspektoratit të Punës, Nr.01/06-150/20, i datës 08.12.2020 të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm nga data 28.12.2020, me të cilin Urdhër është detyruar debitorja që në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj shumën prej 215.48 euro, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë t’ia paguaj shumën prej 914.00 euro, apo në total shumën prej 1,229.48 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka ushtruar Prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar përmbarimin me arsyen se i njëjti nuk është i bazuar në dispozita ligjore, duke shtuar se në bazë të nenit 5, par. 6 pikal dhe 2 të LPP-së dhe në bazë të

udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës Gj.A.Su.36/21, dt.05.02.2021, është revokuar Udhëzimi Gj.A.Su.A.nr.189/20, dt.25.09.2020, dhe tani organ kompetent përbarimor për të vendosur në procedurën e përbarimit dhe për të zbatuar përbarimin në të gjitha çështjet familjare, kthimin e punëtorëve në punë dhe kompensimet tjera, është gjykata, pa marrë parasysh se vendimin përbarues se kush e ka marrë. Nga këto arsye ka kërkuar që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përbarimit i lëshuar nga përbaruesi privat.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, ku ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur me asnjë nga shkaqet, ashtu siç e kërkon neni 71 LPP-së. Tutje ka theksuar se debitori e ka paraqitur prapësimin vetëm për qëllim zvarritjes së procedurës. Pretendimet e debitorit se urdhri përbarimor nuk është i bazuar në dispozitat ligjore janë të pa vërteta, ngase përbaruesi privat e ka caktuar përbarimin në përputhje me dispozitat e LPP-së, dhe se vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/06-150/20, i datës 08.12.2020, i formës së prerë nga data 28.12.2020, mbi bazën e të cilit është caktua përbarimi paraqet titull ekzekutiv konform neni 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, ndërsa debitori nuk ka ofruar ndonjë provë me anë të së cilës vërtetohet se vendimi në fjalë është prishur, anuluar, ndryshuar, shfuqizuar apo të ketë humbur efektin e tij juridik. Tutje ka theksuar se bazuar në nenin 5 par.6 pika 6.2 të LPP-së, gjykata është kompetente për ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me kthimin e punëtorëve në punë, mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me kompensimin e pagës jubilarë për 13 vite dhe kompensimin e ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë, e që për këto lloje të kompensimeve një kompetencë e tillë me qëllim të efikasitetit iu është dhënë përbaruesve privat. Po ashtu ka theksuar se shkaqet për prapësim janë të paraparë në mënyrë të saktë në nenin 71 të LPP-së dhe se me nenin 69 par.4 të LPP-së, parashihet se baza për prapësim duhet të mbështet në prova të duhura dhe të njëjtat të dorëzohen me shkrim, në të kundërtën prapësimi refuzohet. Në fund ka theksuar se debitori për thëniet e veta nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vlefshme dhe se qëllimi i vetëm i prapësimit ka qenë prolongimi i procedurës. Nga këto arsye ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorës të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkrësive të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përbarimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përbarim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përbarimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përbarim është paraqitur duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës, Nr.01/06-150/20, i datës 08.12.2020 të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm nga data 28.12.2020. Në bazë të shqyrtimit të këtij vendimi, Gjykata gjen se në dispozitiv të të njëjtit është aprovuar si e bazuar ankesa e kreditorës S./M, dhe është obliguar debitorja që në afat prej 8 ditësh të bëjë kompensimin në vlerë 50% të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimin për ushqimin gjatë punës, për ditët e pranisë në punë.

Megjithatë, këtij Vendimi i mungon shuma e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorës, si një nga elementet që duhet t'i përmbajë dokumenti përmbarimor për të qenë i përshtatshëm për përmbarim.

Në prezencën e rrethanave të tilla, Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike nuk i përmbushë kushtet për të qenë i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës nga neni 27 par.1 lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se në shkresat e lëndës, përveç vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi janë të bashkangjitura edhe prova tjera si: kontrata e punës, vërtetimi për përvojën e punës, ankesa, si dhe ekspertiza financiare, mirëpo Gjykata nënvizon faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale siç është procedura përmbarimore, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përmbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, që në rastin konkret është vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/06-150/20, i datës 08.12.2020 i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 28.12.2020.

Bazuar në këto arsye, meqë Urdhëri Përmbarimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përmbarim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e anuluar Urdhërin për lejimin e Përmbarimit P.nr.61/21, të datës 02.03.2021, të lëshuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj në Pejë dhe aborguar të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra, si dhe duke e refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbarim të parashtruar nga kreditorja.

Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

– Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.718/21, datë 17.10.2023

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.